



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:247015

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06266871

2023:247016

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.G me vendbanim në fsh. G.P-K.Shtime, me nr. personal, të cilën e përfaqëson av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi me autorizim Lulzim Muharremi, me objektin e kontestit kompensim i diferencës për licencim, vlera e kontestit 1840€, jashtë seancës, më dt. 08.10.2024 ka marrë këtë;

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.G me vendbanim në fsh. G.P-K.Shtime, me nr. personal, kundër të paditurës Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna Shtimes-Drejtoria e Arsimit që paditëses E.G: për periudhën nga data 13.04.2022-31.01.2023, për 11 muaj e gjysmë, t'ia kompensojë në emër të licencimit për kualifikim shumë e përgjithshme prej 1840€ (njëmijë e tetëqind e katërdhjetë euro), si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja përmes të autorizuarit të saj av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, më 15.11.2023, kanë ushtruar padinë kundër të paditurës, lidhur me çështjen e mos pagesës së diferencës në pagë që rrjedh nga e drejta e licencimit. Ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna Shtimes-Drejtoria e Arsimit që paditëses E.G: për periudhën nga data 13.04.2022-31.01.2023, për 11

muaj e gjysmë, t'ia kompensojë në emër të licencimit për kualifikim shumë e përgjithshme prej 1840€ (njëmijë e tetëqind e katërdhjetë euro), si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm. Ka shtuar se paditësja gjendet në marrëdhënie pune tek e paditura dhe punon si mësimdhënëse e lëndës së kimit në SHML Naim Frashëri në Shtime dhe SHFMU Skenderbeu në Raçak dhe posedon titullin master i mësimdhënies lëndore (me specializim në kimi). Në bazë të kontratës së dt. 12.04.2022 paga bazë e paditëses është 459.95€ dhe gjatë periudhës së marrëdhënies së punës prej dt. 13.04.-31.08.2022 për 6 muaj e gjysmë e paditura nuk ja ka paguar pagën shtesë në emër të licencimit në shumat mujore prej 170€ përkatësisht 1105€. Ndërsa në bazë të kontratës paga bazë e paditëses është 421€ dhe gjatë periudhës së marrëdhënies së punës prej dt. 01.09.2022-31.01.2023 për 5 muaj e paditura nuk ja ka paguar pagën shtesë në emër të licencimit në shumat mujore prej 147€ përkatësisht 735,00€.

E paditura në përgjigje në padi të dt. 21.06.2024 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se padia dhe kërkesëpadija janë të parashkruara, po ashtu edhe kontrata kolektive e arsimit të vitit 2021 me nuk është në fuqi. Ka shtuar se Komuna nuk ka mundur të krijojë vijë buxhetore për të kryer këto pagesa që i parasheh kontrata kolektive e arsimit. Për të gjitha këto arsye konsideron se padia dhe kërkesepadija nuk kanë baze ligjore. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Kontrata e punës e dt. nr prot...., Kontrata e punës e dt. ... nr prot...., diplomë e masterit e UP-Fakulteti i Edukimit e dt. ... nr prot. ... e noterizuar, licencë e mësimdhënësit nr ... e dt. ..., listën e pagave të muajit maj 2022, mars 2023, prill 2023.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadija e paditëses është në tërësi e pabazuar.

Me leximin e kontratës së punës e dt. ... nr prot.... vërtetohet se paditësja dhe e paditura kanë lidhur kontratë pune, ku paditësja punësohet në SHML gjimnazi NAIM FRASHËRI, me titullin e punës mësimdhënëse e lëndës kimi 8 orë në SHML Gjimnazi Naim Frashëri, 10 orë në Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale në Shtime dhe 2 orë në SHFMU Skënderbeu në Raçak. Paga

mujore (bazë) e paditëses ishte: 459,95€, përvoja e punës 0.00€, gradimi 0.00€, paga bruto 459.95€. Kohëzgjatja e kontratës me kohë të caktuar fillon më 13.04.2022-31.08.2022.

Me leximin e kontratës së punës e dt. ... nr prot.... vërtetohet se paditësja dhe e paditura kanë lidhur kontratë pune, ku paditësja punësohet në SHFMU Emin Duraku në Shtime, me titullin e punës mësimdhënëse e lëndës kimi 6 orë në Shkollën e mesme të lartë profesionale në Shtime, 6 orë në SHFMU S... në Reçak dhe 8 orë në SHFMU E... në Shtime. Paga mujore (bazë) e paditëses ishte: 421,2€, përvoja e punës 0.00€, gradimi 0.00€, paga bruto 421,2€. Kohëzgjatja e kontratës me kohë të caktuar fillon më 01.09.2022-31.08.2023.

Nga lista e pagave e muajit maj 2022, vërtetohet se paditësja kishte pagë neto 415.19€, pagë bruto 459.95€, paga bazë 459€.

Nga lista e pagave e muajit mars 2023, vërtetohet se paditësja kishte pagë neto 524.94€, pagë bruto 588€.

Nga lista e pagave e muajit prill 2023 vërtetohet se paditësja kishte pagë neto 526.20€, pagë bruto 859.47€.

Nga licenca e lëshuar nga MASHT nre dt. ..., vërtetohet se paditësja ka nivelin e licencës të rregullt, lloji i licencës licencë e karrierës, data e lëshimit ..., data e skadimit 03.07.2030.

Nga diplomë e masterit e noterizuar e UP-Fakulteti i Edukimit e dt. 02.08.2021 nr prot. e noterizuar, gjykata ka vërtetuar paditësja ka diplomë master në Universitetin e Prishtinës-Fakulteti i Edukimit dhe ka marrë titullin master i mësimdhënies lëndore (me specializim në kimi).

Zbatimi i së drejtës materiale

Sipas nenit 2, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të punës, është paraparë se: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës”.

Sipas 90 të këtij ligji, është paraparë se: “1.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose

kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”.

Sipas nenit 4, parag. 2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”.

E po ashtu lidhur me këtë sipas nenit 3, parag.1, pika 1.8 i këtij ligji ka paraparë se shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim ”Kontrata kolektive është marrëveshje ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur” kurse me pikën. 1.11 të po këtij paragrafi është paraparë se “Kontrata e punës është akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Sipas nenit 8, parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”.

Me Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 i datës 29.08.2008 shprehimisht në pikën 4.3 parashihet se: “mësimdhënësit, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë një rritje page bazë prej 27%.

Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr. 214/2023, i datës 09.10.2023, në pikën I. të tij ka paraparë se: “Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”

Sipas nenit 399.1 të LPK parashihet që: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”, ndërsa sipas nenit 399.2 të LPK parashihet që: “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pabazuar dhe të njëjtën e ka refuzuar në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo për faktin kryesor se nga licenca e lëshuar më dt. 03.07.2023 nga MASHT-i, me numër 1032010, vërtetohet se paditësja ka përfituar licencën më dt. 03.07.2023, nivelin e licencës të rregullt, lloji i licencës licencë e karrierës. Nga kjo provë vërtetohet se MASHT, ja ka lëshuar licencën paditëses më dt. 03.07.2023, me datë të skadimit 03.07.2030.

Ndërsa periudha e kërkuar me kërkesëpadinë e paditëses përfshin periudhën kohore nga data 13.04.2022-31.01.2023.

Nga kjo rrjedhë përfundimi i drejtë dhe i ligjshëm se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pathemeltë, për arsyen se paditësja nuk e ka poseduar licencën gjatë kohës së kërkuar me kërkesëpadi përkatësisht gjatë periudhës nga data 13.04.2022-31.01.2023.

Licencën paditësja e ka përfituar nga MASHT më dt. 03.07.2023. Data e skadimit të kësaj licence është 03.07.2030.

Edhe me anë të listave të pagave të lëshuara nga ministria e financave e RKS të muajve maj 2022, mars 2023, prill 2023, nuk vërtetohet që paditësja kishte përfituar ndonjë shtesë në pagë në emër të licencimit.

Nuk ka qenë fakt kontestues në këtë çështje juridiko-civile se paditësja posedon diplomë master i mësimdhënies lëndore (me specializim në kimi), por kontestues ishte fakti se a i posedon kushtet ligjore paditësja që të kërkojë diferencë në pagë në emër të licencimit.

Poashtu me anë të leximit të kontratave të punës të dt. 12.04.2022 nr prot.05/272 dhe të dt. 14.07.2022 nr prot.05/560, vërtetohet që paditësja nuk ka përfituar ndonjë të ardhur në emër të gradimit.

Në bazë të dispozitës ligjore të nenit 399.1 të LPK parashihet që: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”, ndërsa sipas nenit 399.2 të LPK parashihet që: “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”

Nga dispozita e cituar ligjore, në raport me shkresat që gjinden në fashikullin e lëndës, rezulton që kërkesëpadia është e pathemeltë për arsyen se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi dhe faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate meqë paditësja gjatë kohës kur kërkon diferencën në emër të licencimit nuk ka pasur licencë, ndërsa licencën e ka përfituar më dt. 03.07.2023, rezulton që kërkesëpadia e paditëses nuk ka bazë juridike në vendimin e qeverisë së Kosovës Nr.01/33 i datës 29.08.2008 dhe as në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr. 214/2023, të datës 09.10.2023.

Vendosja jashtë seancës e gjykatës në këtë çështje gjen mbështetje edhe në rastet e GJEDNJ, Rasti Jussia kundër Finlandës nr. 73053/01, pika 41 dhe Rasti Saccoccia kundër Austrisë nr. 69917/01, final 04.05.2009, pika 76.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendosë konform nenit 450 të LPK.

Konform nenit 399 të LPK, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 08.10.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.